



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 93

Prishtinë, më 14.02.2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla –S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, NezirÇoçaj, ArmendZemaj, Agim Ademaj, Pal Lekaj dhe Valdete Bajrami.

Munguan: Albulena Haxhiu, Doruntinë Maloku dhe MilenaMiliçeviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Gresa Ramadani, praktikante; Granit Berisha dhe EgzonPacolli, praktikë; Dren Ajeti- GLPS; Yll Zeqaj, Oda e Avokatëve; Florent Spahiu dhe Blerta Aliu, KDI; Genc Nimoni, Çohu; Dibran Istrefi, Klan KOSOVA; AdnanIsufi dhe AgafaBowten, EULEX; LandLepashtica, BIRN; Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office; Lumnije Murati, ZPRK dhe Mentor Boja.

Mbledhjen e kryesoi, Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Nga Staf i Mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 28 dhe 30 dhjetor 2016;
3. Shqyrtimi Raportit të grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjeve 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033 dhe Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-035;

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr.05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-130 për Shërbime;
6. Shqyrtimi në parim i Projekt-kodit nr. 05/L-146 i Drejtësisë për të Mitur;
7. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-145 për plotësim dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë;
8. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-140 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e interesit publik;
9. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-147 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore;
10. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-144 për Noterinë;
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime. Formimi i Grupeve punuese për secilin Projektligj të miratuar dhe njoftim për caktimin e dëgjimit publik në lidhje për marrëveshjen për drejtësi.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 28 dhe 30 dhjetor 2016

Kryesuesjakonstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura më 28 dhe 30 dhjetor 2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjeve 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033 dhe ligjit nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-035

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim raportin e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-033 dhe Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-035 dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje apo sugjerim.

ArmendZemaj, në cilësinë e kryesuesit të grupit punues, tha se është një prej aktiviteteve më të rëndësishme që ka Komisioni në rolin e mbikëqyrjes duke pohuar se ka qenë specifike krijimi i raporteve të ndërsjella mes institucionit të Kuvendit dhe Gjyqësisë si pushtete të ndara. Kemi arritur t'i kalojmë disa barriera të së kaluarës dhe po ashtu t'i heqim disa keqkuptime dhe të ndërtojmë një raport ndërinstitutional, i cili besoj se do të ndihmojë në reformimin dhe avancimin e sistemit të drejtësisë në vend. Grupi punues në përbërje nga të gjitha grupet politike ka zhvilluar aktivitetet e tij duke marrë parasysh edhe bashkëpunimin me shoqërinë civile që nga fillimi i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, hartimit të rregullave, përcjellja e aktiviteteve tona.

Ndërsa para se të përfundojë raporti ne kemi mbajtur një dëgjim publik me të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë, ku kanë dhënë mendimet rreth zbatimit,por edhe plotësim ndryshimit të ligjeve në fjalë. Më tej z. Zemaj sqaroi se aktivitetet janë të përshkruara në hollësi duke pohuar se jemi munduar që të përshkruajmë pyetjet, përgjigjet, dilemat dhe opinionet që kanë dalë nga Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, gjykatat, deputetët dhe shoqëria civile,ku të gjitha janë pjesë e raportit. Z. Zemaj theksoi se i kanë lënë hapësirë edhe anëtarëve të tjerë të Komisionit që nuk kanë qenë pjesë e grupit punues për të sjellë rekomandimet e tyre nëse do të kishin por deri më tani askush nuk ka sjell rekomandime dhe kërkoi nga anëtarët që të votohet dhe të dërgohet për diskutim në Kuvend.

Pal Lekaj kërkoi të sqarohet se çfarë është menduar kur është thënë se duhet të ndryshohet mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit Prokurorial nga Kuvendi.Po ashtu edhe me decentralizim çfarë është menduar?

ArmendZemaj, duke ju përgjigjur z. Lekaj, tha se Komisioni shpeshherë ndër pikat që ka është edhe ndryshim plotësimi i ligjeve. Në vitin 2015 në procedurë të shpejtë është bërë ndryshim plotësimi ligjeve për Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial që ka pas të bëjë me zgjedhjen e anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ndryshimet Kushtetuese që janë përkrahur nga shumica Parlamentare ku tani më për zgjedhja e anëtarëve të KGJK-së dhe KPK-së është kompetencë ekskluzive gjyqësorit, përveç zgjedhja e komuniteteve që ka mbetur si kategori Kushtetuese të cilën e bën Kuvendi. Mënyra e ndryshimit të zgjedhjes nga Kuvendi ku ne kemi futur disa masa të cilat Kuvendi për shkak të votës së kualifikuar nuk mund të arrijë në zgjedhjen e një anëtarë të Këshillit Prokurorial. Po ashtu ligjet për këto dy këshilla mos të na vinë të ndryshme por të jenë të njëjta duke nënkuptuar gjithmonë mandatin kushtetues dhe ligjor që kanë për të rritur efikasitetin në luftimin e dukurive negative,por edhe në rritjen e performancës. Gjatë vizitave në terren nëpër gjykata dhe me ligjin e fundit KGJK- ja ka bartur kompetencat nga sekretariati te kryetarët e gjykatave për çështje financiare dhe të prokurimit. Me ligjin për prokurim publik përfaqësuesi i organizatës buxhetore është kryetari dhe na është thënë nga të gjithë kryetarët e gjykatave se nënshkrimi i kontratave të prokurimit bien ndesh edhe me punën që ata bëjnë përveçse është edhe një ngarkesë tejet e madhe.Kjo është vetëm si e gjetur dhe është dhënë rekomandim që të rishikohet me ligjin dhe KGJK ta ketë parasys.

Agim Aliu tha se është vërtet konstatim i mirë që ka kohë që ne, si Komision, e kemi diskutuar gjatë fazës së raporteve dhe projektligjeve të ndryshme. Ajo që duhet të potencoj është fakti se duhet të merremi më me këmbëngulësi është pika 1 e rekomandimit sepse ne kemi bërë shumë ndryshime dhe plotësime të projektligjeve me procedura të përshpejtuara,por tani ne po i shohim defektet që po manifestohen në punën e këtyre organeve në praktikë,madje në nivelin e ekzistencës së kuorunit. Ne, si politikë dhe Kuvend,kemi treguar vullnetin maksimal që të kemi një pavarësi të gjyqësorit duke pohuar se në ligjet e ardhshme do duhej ta diskutonim këtë çështje se vërtet kjo pavarësi e gjyqësorit është duke shkuar në funksion të drejtësisë duke mos u krijuar grupe të caktuara brenda institucioneve të drejtësisë që ata të menaxhojnë këtë pavarësi që e gëzojnë. Puna jonë mbetet që edhe si Komision,por në bashkëpunim me Ministrinë e

Drejtësisëtë kemi sa më shumë projektligje që e përmirësojnë punën e sistemit të drejtësisë dhe jam ‘për’ që ky raport të votohet dhe të dërgohet në Kuvend.

ArmendZemaj,shtoi se puna jonë ka qenë që të ruhet pavarësia e dy pushteteve dhe duke e ruajtur pavarësinë vjen në shprehje ajo që ju kërkoni për t’u rritur llogaridhënia dhe të kërkohet performancë e dy trupave të KGJK-së dhe KPK-së që përfshin edhe menaxhimin e gjykatave dhe të prokurorive dhe kjo besoj që është e drejtë si përfaqësues të qytetarëve dhe ligjvënës që ta kërkojmë.

Pas diskutimeve, *kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:*

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet raporti me rekomandime i Komisionitpër Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L -033 dhe 05/L-094, dhe Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L -03.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, por është një shqetësim tek amendamenti 11, paragrafi 4,sepse bie ndesh me ligjin për ndërmarrjet publike dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me këtë.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm me përjashtim të amendamentit 11
 2. I rekomandohet Komisionit FunkSIONAL që ta rishikojë amendamentin 11.
- #### **5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L- 130 për Shërbime**

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-130 për Shërbime dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-130 për Shërbime me amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi në parim i Projekt-kodit nr. 05/L-146 i Drejtësisë për të Mitur

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim në parim Projekt-kodin nr. 05/L-146 i Drejtësisë për të mitur dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet, në parim, Projekt-kodi nr. 05/L-146 i Drejtësisë për të mitur

7. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-145 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin nr. 05/L-145 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 05/L-145 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/26 trashëgiminë në Kosovë

8. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-140 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryesuesjaparaqiti për shqyrtim në parim Projektligjin nr. 05/L-140 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 05/L-140 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

9. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-147 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin nr. 05/L-140 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 05/L-147 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore

10. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-144 për Noterinë

Kryesuesjaparaqiti për shqyrtim në parim Projektligjin nr. 05/L-144 për Noterinë dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 05/L-144 për Noterinë

11. Të ndryshme

A. Formohet Grupi Punues për Projekt- kodine Drejtësisë për të Mitur nr. 05/L-146 në këtë përbërje:

- ArmendZemaj- kryesues,
- NezirÇoçaj – anëtar,
- Danush Ademi- anëtar.

B. Formohet Grupi Punues për Projektligjin nr. 05/L-145 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004 /26 për trashëgiminë në Kosovë në këtë përbërje:

- Pal Lekaj- kryesues,
- NezirÇoçaj – anëtar,
- Valdete Bajrami- anëtare.

C. Formohet i Grupit Punues për Projektligjin nr.05/L-140 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin funksionit publik me këtë përbërje:

- Agim Ademaj – kryesues,
- Agim Aliu – anëtar,
- Pal Lekaj – anëtare.

D. Formohet Grupi Punues për Projektligjin nr. 05/L-147 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore me këtë përbërje:

- Agim Aliu – kryesues,
- Agim Ademaj – anëtar,
- Pal Lekaj – anëtare.

E. Formohet Grupi Punues për Projektligjin nr. 05/ L-144 për Noterinë me këtë përbërje:

- ArmendZemaj– kryesues,
- Selvije Halimi – anëtare,
- Valdete Bajrami- anëtare dhe
- Pal Lekaj- anëtar.

F. Njoftim

Kryesuesjai njoftoi se pak më herët pati një takimim me Jeta Krasniqi, KDI, lidhur me Projektin e Mbikëqyrjes së Drejtësisë në Veri dhe propozoi që të thërrasin në Dëgjim Publik, znj. Dhurata Hoxha, Ministre e Drejtësisë dhe znj. Edita Tahiri, ministre për Dialog. Po ashtu kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje apo sugjerim.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që të ftohen znj. Edita Tahiri, ministre për Dialog dhe znj. Dhurata Hoxha, ministre për Drejtësi në Dëgjim Publik me dt. 22.02.2017 në orën 11:00.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryesuesja e Komisionit,

Selvije Halimi